

Shërbimi
i Securisë Pleurore
18/03/2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI I SHQIPËRISË

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ___ /03/2022

Lënda: Për një ndryshim në ligjin Nr. 7895, datë 27.01.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar”

Drejtuar: Znj. LINDITA NIKOLLA

KRYETARE E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

E nderuar zonja Kryetare,

Bazuar në nenin 81, pika 1, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, si edhe në nenin 68, të Rregullores së Kuvendit, paraqes për shqyrtim dhe miratim në Kuvend të projektligjit “Për një ndryshim në ligjin Nr. 7895, datë 27.01.1995, Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar”

Bashkëlidhur gjeni tekstin e projektligjit dhe relacionin përkatës.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin.

Deputetët Propozues

MONIKA KRYEMADHI

PETRIT VASILI

ERISA XHIXHO



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

PROJEKT LIGJ

Nr. _____/2022

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 7895, DATË 27.1.1995, “KODI PENAL I
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË” TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 81, pikat 1 dhe 2, shkronja “d” dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e një deputeti, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, bëhet ndryshimi i mëposhtëm:

Neni 1

Paragrafi i parë i nenit 262 ndryshohet si më poshtë:

“Organizimi i grumbullimeve dhe i manifestimeve të personave në sheshe dhe vende të kalimit publik, pa njoftuar me shkrim organin kompetent sipas procedurave të parashikuar në ligj, apo kur nga organizatorët shkelen kushtet e parashtruara prej tyre në njoftimin me shkrim drejtuar organit kompetent, përbën kundërvajtje penale dhe dënohet me gjobë ose me burgim gjer në gjashtë muaj”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

LINDITA NIKOLLA